

DEKLARATË PRIVATËSIE

LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE TË VIKTIMAVE NË PROCESHE GJYQËSORE

Përmbajtja

1. HYRJE.....	1
2. QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE	1
3. TË DHËNAT QË PËRPUNOHEN.....	1
4. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E PËRPUNIMIT	2
5. MARRËSIT E TË DHËNAVE	2
6. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE, QASJA NË TO DHE KORRIGJIMI I TYRE.....	2
7. ARSYEJA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE.....	2
8. PERIUDHA E MBAJTJES SË TË DHËNAVE	2
9. KONTAKTI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE	2
10. ANKESAT.....	2

1. HYRJE

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) u përmbahen standardeve më të larta në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Kur individët bëjnë kërkesë për t'u pranuar si viktimë pjesëmarrëse në proceset e DHSK-së. DHSK-ja e përdor informacionin e dhënë për të shqyrtuar kërkesat në pajtim me kornizën ligjore në fuqi. Në pajtim me nenin 34(11) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, punonjësi për mbrojtjen e të dhënave i DHSK-së udhëhiqet nga standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo deklaratë për privatësinë ju tregon se çfarë mund të prisni kur DHSK-ja mbledh të dhënat tuaja personale.

2. QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Qëllimi është mbledhja dhe shqyrtimi i kërkesave të viktimave për pjesëmarrjen në proceset e DHSK-së.

3. TË DHËNAT QË PËRPUNOHEN

Të dhënat që përpunohen për qëllimin e lartpërmendur janë të dhënat e shënuara nga ju në kërkesën për pranim si viktimë pjesëmarrëse në procese gjyqësore.

Për të mbrojtur sigurinë e të dhënave personale dhe për të parandaluar qasjen, ndryshimin, fshirjen dhe nxjerrjen e paautorizuar të të dhënave, zbatohen masa të përshtatshme organizative dhe teknike.

4. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E PËRPUNIMIT

Autoriteti përgjegjës që përcakton qëllimin dhe mjetet e procesit të përpunimit të të dhënave është DHSK-ja.

5. MARRËSIT E TË DHËNAVE

Të dhënat tuaja merren nga:

- personel i autorizuar i DHSK-së, kontraktues individualë që veprojnë në emër të DHSK-së dhe individë që janë pjesëmarrës në procese gjyqësore.
- mbrojtësi i viktimave i caktuar për çështjen dhe ekipi i vet.

Kërkesa për praninë si viktimë pjesëmarrëse në procese i bëhet e njohur gjykatësit të procedurës paraprake, gjykatësve të trupit gjykues dhe bëhet pjesë e dosjes së procesit gjyqësor. Emri, mbiemri dhe të dhëna të tjera identifikuese tuajat mund t'u bëhen të njohura publikut, mbrojtësit të të akuzuarit si dhe të akuzuarit, dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (Prokurorisë).

Të gjithë ata që kanë qasje në përpunimin e të dhënave personale apo kanë lidhje me to janë të obliguar që ta respektojnë konfidencialitetin e këtyre të dhënave. Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale do të respektohen dhe zbatohen rreptësisht gjatë të tërë procedurës.

6. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE, QASJA NË TO DHE KORRIGJIMI I TYRE

Ju mund të kërkonti qasje në të dhënat tuaja personale dhe mund të kërkonti korrigjimin e të dhënave personale të pasakta ose jo të plota.

7. ARSYEJA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i të dhënave personale lidhur me kërkesat për praninë si viktimë pjesëmarrëse në procese gjyqësore, është i domosdoshëm për kryerjen e funksioneve zyrtare të DHSK-së në interesin publik.

8. PERIUDHA E MBAJTJES SË TË DHËNAVE

Të dhënat personale që kanë lidhje me procesin e kërkesave për praninë si viktimë pjesëmarrëse janë pjesë e dosjes zyrtare të mbështetjes gjyqësore dhe mund të mbahen përgjithmonë për qëllime arkivimi dhe historike.

9. KONTAKTI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Nëse keni pyetje që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave tuaja personale, ju lutemi kontaktoni punonjësën e mbrojtjes së të dhënave në dataprotection@scp-ks.org.

10. ANKESAT

Ju keni të drejtë ankese në çdo kohë dhe mund të kontaktoni LegalCounsel@scp-ks.org.